DEKRET
Nr.256, datë 17.7.1992

PËR FALJEN E KREDIVE TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave

DEKRETOJ:

Neni 1

Falen kreditë e kooperativave bujqësore ndaj Bankës Bujqësore të realizuara në datën 30 qershor 1992 me një shumë prej 1947 milionë lekë.

Neni 2

Detyrimet e mësipërme i kalojnë buxhetit të shtetit.
Për të mbuluar humbjen që rezulton pranë sistemit bankar si pasojë e këtij veprimi ngarkohet Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të emetojë obligacione shtetërore me vleftën 1947 milion me një interes vjetor prej 30 për qind dhe t'i depozitojë këto obligacione pranë Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Banka e Shqipërisë dhe Banka Bujqësore për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar nga Kuvendi Popullor me ligjin nr.7614, datë 28.9.1992.